



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2267/6 prot.

Datë 01.12.2022

**V E N D I M**

**Nr. 1185 /2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “TEA-D” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-39629-08-24-2022, me objekt: “*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*” me fond limit 12.123.198,38 (*dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë e tetë*) lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 14.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “TEA-D” SHPK  
*Adresa: Libohovë, Gjirokastër.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Gjirokastër.  
*Adresa: Sheshi Çerciz Topulli, Gjirokastër.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.08.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-39629-08-24-2022, me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fond limit 12.123.198,38 (dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 14.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

II.2. Në datën 14.09.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 28.09.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- “TEA-D” SHPK	0 lekë skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK	11.430.265,35 lekë kualifikuar
- “2Z Konstruksion” SHPK	11.827.236,62 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 28.09.2022 operatori ekonomik “TEA-D” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon: “Formulari i ofertës ekonomike nuk është sipas shtojcës 1 të DST, pasi keni ofertuar me dy vlera të ndryshme, me një diferencë më të madhe se 2%. Bazuar në nenin 92 të LPP pika 1, nuk lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, si dhe në mbështetje të VKM 285/2021 neni 82 pika 3 Oferta me gabim aritmetik refuzohen kur shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më e madhe se 2% e vlerës së ofertës ekonomike.”

II.5 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se më datë 10.10.2022 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

II.6. Në datën 17.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2267 prot, datë 17.10.2022, e operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2267/2 prot., datë 18.10.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 11083/1 prot, datë 24.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2267/3 prot., datë 27.10.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK.

II.8.1. Nga informacioni i mësipërm rezulton se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 2267/4 prot., datë 02.11.2022, operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik “*Formular i paraqitjes së argumenteve*” ku përveç faktit që kundërshton vendimmarrjen e AK, vetë operatori ankimues pranon, se edhe në disa procedura të mëparshme ka dorëzuar **shtojçën 1** në të njëjtin format, si në procedurën aktuale objekt-ankimi, duke sjellë si pasojë skualifikimin e ofertës së tij.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Në datën 25.08.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-39629-08-24-2022, me objekt: “*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*” me fond limit 12.123.198,38 (*dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë e tetë*) lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 14.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

III.2. Në datën 14.09.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.3. Në datën 28.09.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- “TEA-D” SHPK	0 lekë skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK	11.430.265,35 lekë kualifikuar
- “2Z Konstruksion” SHPK	11.827.236,62 lekë skualifikuar

III.4. Në datën 17.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2267 prot, datë 17.10.2022 e operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

III.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2267/2 prot., datë 18.10.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK.

III.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se më datë 10.10.2022 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe në buletinin e njoftimeve publike me Nr. 143 datë 17 Tetor 2022.

III.7. Me shkresën nr. 11083/1 prot, datë 24.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2267/3 prot., datë 27.10.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues “TEA-D” SHPK.

III.7.1. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues me pretendimin se: *[...operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike në kundërshtim me dokumentet standarde të tenderit për procedurën e prokurimit. Pra bazuar në formularin e çmimit të ofertës së paraqitur (jo sipas shtojcës 1 të dst-ve) ky operator ekonomik ka ofertuar me dy vlera të ndryshme: me vlerën 9.557.600 lek pa TVSH dhe 9.844.328 lek pa TVSH me një diferencë më të madhe se 2%.*

*Bazuar në nenin 92 të LPP pika 1, parashikohet se: Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshime në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Gjithashtu në mbështetje të VKM 285/2021 neni 82 pika 3, Oferta me gabim aritmetik refuzohen kur shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më e madhe se 2% e vlerës së ofertës ekonomike. “Dokumentet standarde të tenderit janë dokumente që autoriteti kontraktor i vendos në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave..... OE janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST. Sa më sipër personi i autorizuar i autoritetit kontraktor vlerësoi dhe vendosi të refuzojë ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.]*

III.8. Në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.8.1. Referuar DST :

**Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontrates.

**Seksioni II: Shtojcat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës**

Seksioni II përfshin formularët, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, Preventivi i punimeve, projektet e ndryshme teknike, Grafiku i punimeve, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, termat e referencës apo detyrën e projektimit, nëse është rasti, që përshkruajnë punimet që do të prokurohen.

**Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika 4/2** “Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sikurse është bërë publikimi në Dokumentet e Tenderit.

**Formularët e Tenderit dhe Preventivat: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.**

**Përgjegjshmëri e ofertave: 1.** Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) “**Devijim**” është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) “**Rezervim**” është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) “**Mospranim**” është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit .

**2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.**

III.9. Referuar DST-së Shtojca 1;

Shtojca I. (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) *Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.*
- (b) *Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].*
- (c) *Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.*
- (d) *Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:*
1. *Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;*
  2. *Njoftimin e Kontrates;*
  3. *Kriteret e Vlerësimit;*
  4. *Kriteret e Përzgjedhjes;*
  5. *Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;*
  6. *Preventivin e çmimeve*
  7. *Termt e referencës (nëse është rasti)*
  8. *Detyrën e projektimit (nëse është rasti)*
  9. *Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
  10. *Kushtet e Veçanta të Kontratës;*
- (e) *Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];*
- (f) *Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]*

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

III.9.1. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se operatori ekonomik “TEA-D” SHPK, në përmbushje të kërkesave në DST, ka paraqitur formularin e ofertës në formën si më poshtë vijon:

- (e) **Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 9.557.600 [Nente milion e peseqind e pesedhjetë e shtate mije e gjashtëqind];**
- (f) **Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, me fond rezerve është :9.844.328 [memte milior e teteqind e dyzete e kater mije e treqind e njezete e tete**
- (g) **Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 11.813.194 [Njembëdhjetë milion e teteqind e trembëdhjetë mije e njeqind e nentedhjetë e kater]**

III.10. Referuar dokumentacionit të tenderit si edhe dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Në plotësimin e dokumentacionit të ofertës operatorët ekonomikë duhet t'i përmbahen me rigorozitet kërkesave të publikuara në DST duke plotësuar të gjitha dokumentet standarde siç ato janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor, si dhe janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk ka plotësuar në rregull formularin e ofertës pasi ka ndryshuar formatin e shtojcës 1, pjesë e DST, duke krijuar konfuzion për autoritetin kontraktor në vlerësim.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit, pasi rezulton se ka ndryshuar formatin e shtojcës 1, "Formulari i Ofertës", në kundërshtim me dokumentet e tenderit publikuar në SPE ku specifikisht kërkohet: *"Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar."*, kërkesa të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë të mundshëm në një procedurë prokurimi.

Referuar sa më sipër, pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatori ekonomik "TEA-D" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur"*, me Nr. REF-39629-08-24-2022, me objekt: *"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara"* me fond limit 12.123.198,38 (dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 14.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga "TEA-D" SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**